

01-1967



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, me datë 14.04.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR KORRIGJIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV “CERTIFIKATË E PËRDORIMIT” 05 NR. 391/02-199081/21 DT. 28.02.2022

- I. Korrigjohet akti administrativ “Certifikatë e Përdorimit” 05 Nr. 391/02-199081/21 i datës 28.02.2022, i kësaj drejtorie, i lëshuar në emër të aplikuesit Abdullah Zhushi nga Prishtina, me numër të ID 1002316699 për Certifikatën e Përdorimit ndërtesë me destinim për afarizëm – auto servis, me etazhitet P+1 e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, në parcelën kadastrale nr. 1423-47, ZK Prishtinë, sipas Vendimit 05Nr.351/02-118243/19 dt. 30.07.2019 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës. Korrigjimi bëhet në pikën I, të dispozitivit të aktit administrativ të referuar, te emri i investitorit/pronarit dhe atë, në vend të “Abdullah Zhuzhi” duhet të jetë “Abdullah Zhushi”.**
- II. Me këtë vendim korrigjohet akti administrativ “Certifikatë e Përdorimit” i datës 05 Nr. 391/02-199081/21 dt. 28.02.2022, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.**

A r s y e t i m

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, me aktin administrativ “Certifikatë e Përdorimit” të datës 05 Nr. 391/02-199081/21 dt. 28.02.2022, u ka lejuar përdorimin me destinim për afarizëm – auto servis, me etazhitet P+1 e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1423-47, ZK Prishtinë.

Në ndërkohë, ky organ ka vërejtur se në aktin administrativ të referuar, ka rrjedhur një gabim teknik, gjegjësisht në pikën I të dispozitivit të të njëjtit akt, është shënuar gabim emri i investitorit/pronarit në vend të “Abdullah Zhuzhi” duhet të jetë “Abdullah Zhushi”, dhe sipas detyrës zyrtare, pas verifikimit të certifikatës të bashkëngjitur aktit të referuar, korrigjohet gabimi i lëshuar, sipas përshkrimit në pikën I të dispozitivit të këtij akti.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesve/Investitorit, në dosje të lëndës 05 Nr. 391/02-199081/21 dt. 21.09.2021, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-199081/21 DT. 14.04.2022

Zyrtari,
Arbër Morina

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi

Faqe 1 prej 1

Drejtori,
Arber Sadiki



